

VENDIM
Nr.574, datë 14.7.2010

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 722, DATË 19.11.1998 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË
URBANISTIKËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe shtesë:

1. Pika 132 e kreut III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 132. a) Sipas përcaktimit dhe klasifikimit të bërë në nenin 2 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, në rrugët e kategorisë “A”, autostrada, të kategorisë “B”, rrugë interurbane kryesore dhe të kategorisë “C”, rrugë interurbane dytësore, nuk lejohen hyrje–daljet, përveç atyre të përcaktuara në projektin e rrugës.

b) Ndalohet çdo lloj ndërtimi, me përjashtim të pikave të karburantit, në një distancë jo më të vogël se:

i) 30 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorisë “A”;

ii) 25 metra nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “B” dhe “C”;

Pikat e karburantit vendosen në një distancë jo më të vogël se 10 m nga kufiri rrugor i rrugëve të kategorive “A”, “B” dhe “C”.

Në këtë kuptim, “kufi rrugor” konsiderohet fundi i pronësisë rrugore, referuar titujve të pronësisë dhe/ ose brezave të shpronësimit sipas projektit të miratuar.

Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga vija e jashtme e hendekut të sigurimit të kanalit, kur ai ekziston, ose përkatësisht nga vija e sipërme/e poshtme e skarpatës, nëse rruga shtrihet në terren të pjerrët.”.

2. Në fund të pikës 135 të kreut III, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për të gjitha ndërtimet përgjatë rrugëve urbane që ndërlidhin autostradat apo rrugët interurbane kryesore e dytësore (unazat e jashtme dhe/ose rrugët hyrëse në qendrat urbane), përpara miratimit të lejes së sheshit të ndërtimit, subjekti duhet të pajiset me formularin 1/1 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, së bashku me projektin teknik për hyrje-daljen e autorizuar, i cili miratohet nga enti përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e autostradave dhe rrugëve interurbane kryesore e atyre dytësore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha